

**VENDIM**  
**Nr. 720, datë 20.11.2024**

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE  
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KABINETIT TË MINISTRAVE TË  
REPUBLIKËS SË KIRGIZSTANIT, PËR PËRJASHTIMIN E KËRKESAVE PËR VIZË  
PËR MBAJTËSIT E PASAPORTAVE DIPLOMATIKE DHE TË SHËRBIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kabinetit të Ministrave të Republikës së Kirgizstanit, për përjashtimin e kërkesave për vizë për mbajtësit e pasaportave diplomatike dhe të shërbimit, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
**Belinda Balluku**

**MARRËVESHJE**  
**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE**  
**KABINETIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË KIRGIZSTANIT**  
**PËR PËRJASHTIMIN E KËRKESAVE PËR VIZË PËR MBAJTËSIT E PASAPORTAVE**  
**DIPLOMATIKE DHE TË SHËRBIMIT**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Kabineti i Ministrave i Republikës së Kirgizstanit (në vijim të referuara si “Palët”);

*Duke marrë* parasysh dëshirën për të zhvilluar më tej marrëdhëniet e tyre miqësore të ndërsjella;

*Duke synuar* nxitjen, lehtësimin dhe inkurajimin e shkëmbimit të vizitave nga zyrtarët e të dyja Palëve, duke mos zbatuar kërkesën për vizë për mbajtësit e pasaportave të vlefshme diplomatike dhe të shërbimit;

Kanë rënë dakord si më poshtë:

**Neni 1**

1. Shtetasit e Shtetit të njëres Palë, të cilët kanë pasaporta të vlefshme diplomatike ose shërbimi, do të përjashtohen nga kërkesat për vizë për hyrjen, qëndrimin, daljen dhe kalimin transit përmes territorit të shtetit të Palës tjetër (në vijim i referuar si “Shteti pritës”) për një periudhë jo më të gjatë se 90 (nëntëdhjetë) ditë në çdo periudhë prej 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditësh nga data e hyrjes së tyre, me kusht që të mos kryejnë një aktivitet me pagesë në Shtetin pritës dhe pasaportat diplomatike ose të shërbimit janë të vlefshme për të paktën 3 (tre) muaj pas datës së daljes së tyre të synuar nga territori i Shtetit pritës.

2. Shtetasit e Shtetit të njëres Palë, që janë mbajtës të pasaportave diplomatike ose të shërbimit dhe të caktuar si anëtarë të misioneve diplomatike ose posteve konsullore, ose përfaqësues të organizatave

ndërkombëtare të vendosura në territorin e Palës tjetër, duke përfshirë anëtarët e familjes së tyre që i përkasin familjes së tyre, do t'u kërkohet të marrin një vizë të përshtatshme para hyrjes së tyre në territorin e Shtetit pritës për akreditimin.

## Neni 2

1. Personat e specifikuar në nenin 1 të kësaj Marrëveshjeje do të hyjnë dhe dalin nga territori i Shtetit pritës vetëm nëpërmjet pikave të kalimit kufitar të kufirit të Shtetit pritës të përcaktuara për trafikun ndërkombëtar të pasagjerëve dhe që u nënshtrohen të gjitha kërkesave ligjore në fuqi në territorin e Shtetit pritës.

2. Palët do të informojnë njëra-tjetrën menjëherë për çdo ndryshim në legjislacionin e tyre që rregullon hyrjen dhe qëndrimin e shtetasve të huaj.

## Neni 3

Secila Palë rezervon të drejtën të refuzojë pranimin, të shkurtojë ose të ndërpresë qëndrimin në territorin e Shtetit të saj të personave të specifikuar në nenin 1 të kësaj Marrëveshjeje, të cilët konsiderohen të padëshirueshëm ose mund të rrezikojnë sigurinë kombëtare, rendin publik ose shëndetin publik.

## Neni 4

Personat e specifikuar në nenin 1 të kësaj Marrëveshjeje duhet të respektojnë dhe të pajtohen me ligjet dhe aktet e tjera ligjore në fuqi në territorin e Shtetit pritës gjatë të gjithë kohëzgjatjes së qëndrimit të tyre në territorin e Shtetit pritës.

## Neni 5

1. Secila palë rezervon të drejtën të pezullojë, përkohësisht, tërësisht ose pjesërisht, zbatimin e kësaj Marrëveshjeje për arsye të sigurisë kombëtare, rendit publik ose shëndetit publik.

2. Pala tjetër do të njoftohet me shkrim për vendimin e pezullimit të përkohshëm të zbatimit të kësaj Marrëveshjeje ose përfundimit të pezullimit nëpërmjet kanaleve diplomatike. Pezullimi i zbatimit të kësaj Marrëveshjeje dhe përfundimi i pezullimit do të hyjnë në fuqi jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga data e marrjes së njoftimit nga Pala tjetër.

3. Pezullimi i zbatimit të kësaj Marrëveshjeje nuk do të cenojë të drejtat e shtetasve të përmendur në nenin 1 të kësaj Marrëveshjeje, të cilët tashmë qëndrojnë në territorin e Shtetit pritës.

## Neni 6

1. Palët do të shkëmbejnë ekzemplarët e pasaportave diplomatike dhe të shërbimit përmes kanaleve diplomatike jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

2. Në rast të prezantimit të pasaportave të reja diplomatike ose të shërbimit, ose modifikimit të atyre ekzistuese, Palët do t'i përcjellin njëratjetrës ekzemplarët e këtyre pasaportave, nëpërmjet kanaleve diplomatike, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë përpara datës së hyrjes në fuqi të pasaportave ose modifikimeve të reja.

3. Në rast se personat e specifikuar në nenin 1 të kësaj Marrëveshjeje humbin ose dëmtojnë pasaportat e tyre diplomatike ose të shërbimit në territorin e Shtetit pritës, ata do të informojnë

autoritetet kompetente të Shtetit pritës nëpërmjet misionit diplomatik ose një posti konsullor të shtetit të tyre. Misioni diplomatik ose posti konsullor përkatës do t'u lëshojë personave të lartpërmendur, në përputhje me legjislacionin e Shtetit të tij, një pasaportë të re ose dokument udhëtimi për t'u kthyer në Shtetin e tyre.

#### Neni 7

Çdo mosmarrëveshje që lind nga interpretimi i dispozitave të kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet me mirëkuptim nëpërmjet konsultimit ose negociimit midis Palëve nëpërmjet kanaleve diplomatike.

#### Neni 8

1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi pas 30 (tridhjetë) ditësh nga data e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim nëpërmjet kanaleve diplomatike, që konfirmon përfundimin nga palët të procedurave të brendshme përkatëse të nevojshme për hyrjen e saj në fuqi.

2. Me marrëveshje të ndërsjellë të Palëve, kjo Marrëveshje mund të ndryshohet dhe plotësohet me protokolle të veçanta që janë pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje.

3. Kjo Marrëveshje lidhet për një periudhë të pacaktuar dhe është e vlefshme për 3 (tre) muaj nga data e marrjes nëpërmjet kanaleve diplomatike të njoftimit me shkrim, nga njëra nga Palët për synimin e saj për ta denoncuar atë.

Bërë në Nju-Jork, më 23.9.2024, në dy kopje, secila në gjuhën shqipe, kirgize dhe angleze, ku të gjitha tekstet janë njëlloj autentike. Në rast të ndonjë dallimi në interpretim, do të përdoret teksti në gjuhën angleze.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE TË  
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

PËR KABINETIN E MINISTRAVE TË  
REPUBLIKËS SË KIRGIZSTANIT